

AKTI I THEMELIMIT

I FEDERATES SHQIPTARE TE JUDO-S

NENI 1

FORMA LIGJORE, PERBERJA, SELIA

Ne mbështetje të ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 "Per Sportin", Kodit Civil, ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, "Per organizatat jofitimprurese", si dhe ligjit 8789 datë 07.05.2001, "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese", si dhe akte të tjera ligjore dhe nenligjore që rregullojnë këto aktivitete hartohet ky akt themelimi i FEDERATES SHQIPTARE TE JUDO-S .

Kjo federatë është bashkimi i dy shoqatave pra një organizatë e krijuar midis dy personave juridike si më poshtë :

1. Shoqata "KLUBI SPORTIV JUDO "ANTON SHKOZA, perfaqesuar nga kryetari i saj z.Çesk Kimça.(Regjistruar si person juridik me vendimin nr. 1199, datë 06.12.2004)
2. Shoqata "TOP GYM SPORT", perfaqesuar nga kryetari i saj z. Leonidha Kapri.(Regjistruar si person juridik me vendimin nr. 2882, datë 18.06.2010)

Federata Shqiptare e JUDO-s është një organizatë sportive, jofitimprurese, joqeveritare dhe e pavarur.

Federata është krijuar me dëshirën dhe vullnetin e lire të të gjithë themeluesve të saj. Federata mirepret kontributin pozitiv që vjen nga anetaresimet e reja.

NENI 1

EMERTIMI I FEDERATES

Emertimi i federates do të jetë FEDERATA SHQIPTARE E JUDO-s. Federata ka logon dhe vulen e saj, të cilat janë të stampuara dhe të vendosura në çdo dokument të leshuar prej saj, sipas statutit të kësaj Federate.

NENI 2

QELLIMI DHE FUNKSIONET

Federata Shqiptare e JUDO-s ka keto objektiva dhe detyra;

- a) Te zhvilloje, promovojë, kontrolloje dhe rregulloje aktivitetin sportiv të shoqatave dhe klubeve të SHFJ, në të gjitha format e tij e në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me statutin e saj;
- b) Te ndihmojë në mënyrë të kualifikuar në rritjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis anetareve të federatës si dhe të mbrojtë të drejtat e anetareve të saj dhe kujdeset për zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative, sportive, duke u mbështetur në statut, rregullore të saj, legjislacionin shqiptar si dhe aktet ligjore ndërkombëtare të veprimtarisë së sportit përkatës;
- c) Te drejtojë dhe të kujdeset për mbarevajtjen e të gjithë gjyqtarëve të FSHJ, kombëtar dhe ndërkombëtar të aderuar në federatë;
- d) Te organizojë kampionatin kombëtar dhe kupën e Shqipërisë dhe të shpallë "Ekipin Kampion Kombëtar" dhe "Ekipin Fitues të Kupës së Shqipërisë" në sportin e vet;
- e) Te përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në Federatat Nderkombëtare përkatëse .
- f) Te organizojë ekipin kombëtar dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anetareve të saj në keto veprimtari;
- g) Te organizojë në Republikën e Shqipërisë, veprimtari sportive ndërkombëtare dhe të japë leje për organizimin e tyre nga anëtarët e saj;

Për zhvillimin sa më të mirë të këtij objekti ajo do të organizojë edhe programe të përbashkëta me organizatat e tjera që kanë lidhje me veprimtarinë e saj në Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj, si dhe do të mbajë lidhje me institucione që i përshtaten objektit të saj.

Federata nuk do të ndjek qëllime politike apo ekonomike. Ajo është organizatë sportive jofitimpruese dhe jo qeveritare.

NENI 3

QENDRA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISE

Qendra e Federatës do të jetë në qytetin e Tiranës, në adresën rruga "Dervish Hima", nr.31.

Federata mund të ndryshojë vendodhjen e selisë së saj sipas kërkesave të ligjit, duke bërë njëkohësisht edhe ndryshimet përkatëse në Regjistrin e Organizatave Jofitimpruese të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe njoftimin e institucioneve përkatëse sipas ligjit.

3.

NENI 4 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se FEDERATES SHQIPTARE E JODO-s eshte e pakufizuar ne kohe.

NENI 5

KUSHTET E PRANIMIT DHE LARGIMIT TE ANETAREVE

Anetar i Federates eshte dhe mund te behet cdo organizate jofitimprurese qe vepron ne perputhje me legjislacionin e vendit dhe ploteson kushtet e meposhtme :
Pranon Statutin, Programin, Rregulloren e Federates si dhe te gjitha detyrimet e parashikuara ne dokumentat themelore. Ben kerkese me shkrim per t'u pranuar anetar, duke u miratuar ajo nga Asambleja e Pergjithshme e Anetareve.
Pagan rregullisht kuotizacionin dhe detyrimet e tjera te percaktuara ne statut.

NENI 6

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ANETARIT

Anetari i FSHJ ka te drejte:

- 1.te pajiset me karten e anetaresimit
- 2.te pajiset me statutin dhe rregulloren e federates shqiptare te JUDO-s
- 3.te perfaqesohet me te drejte vote ne asamblene e pergjithshme.
- 4.te informohet me vendimet e komitetit ekzekutiv te federates
- 5.te pajiset falas me botimet e ndryshme qe ben federata
- 6.te marre pjese ne aktivitete zyrtare dhe miqesore ,kombetare dhe nderkombetare qe organizon FSHJ
- 7.te njihet me pare me programin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme dhe dokumentacionin perkates.

NENI 7 ORGANET E FEDERATES SHQIPTARE

Organet e Federates Shqiptare te JUDO-s jane :

- 1)Asambleja e pergjithshme.

4.

2) Presidenti

3) Komiteti ekzekutiv

Komisionet:

4) Komisioni i disiplines

5) Komisioni i Apelit

6) Komisioni Tekniko Arbitral

7) Komisioni i Finances

NENI 8

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 1) Asambleja e pergjithshme eshte organi me i larte i Federates Shqiptare te JUDO-s. Vetem nje asamble e mbajtur me rregullat e ketij statuti, ka autoritetin te marre vendime.
- 2) Asambleja e pergjithshme perbehet nga te gjithe anetaret e saj te cilet perfaqesohen me 1 (nje) vote.
- 3) Mund te marrin pjese ne asamblene e pergjithshme pa te drejte vote, anetaret e nderit te miratuar nga asambleja e pergjithshme, anetare te komitetit ekzekutiv dhe Sekretari i pergjithshem i Federates Shqiptare te JUDO-s.
- 4) Komiteti Ekzekutiv vendos mbi pjesmarrjen e personave te tjere ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.
- 5) Keta persona nuk kane te drejte vote dhe mund te diskutojne vetem me leje te drejtuesit te asamblese.
- 6) Ne Mbledhjen e pare te kesaj Federate eshte vendosur : Presidenti eshte z.Xhelil Cibaku, kurse Sekretar i Pergjithshem i saj z. Labo Çapo.

NENI 9

VENDIMMARRJA

1. Asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme kur jane prezent me shume se gjysma e delegateve (50%+1) qe kane te drejte te votojne me perjashtim te pikes 2 te ketij neni.

2. Nese shumica e thjeshte (50%+1) nuk arrihet, nje asamble tjeter e pergjithshme duhet te behet 24 ore pas te pares, me te njejtin rend dite.

3. Vendimet e organeve te Federates Shqiptare te JUDO-s nuk mund te jene objekt ankimimi dhe gjykimi ne Gjykatën Civile. Kunder ketyre vendimeve mund te apelohehet ne Keshillin e Arbitrazhit Sportiv prane KOSH dhe me te drejte

5.

1. Asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme kur jane prezent me shume se gjysma e delegateve (50%+1) qe kane te drejte te votojne me perjashtim te pikes 2 te ketij neni.

2. Nese shumica e thjeshte (50%+1) nuk arrihet, nje assemble tjetere e pergjithshme duhet te behet 24 ore pas te pares, me te njejtin rend dite.

3. Vendimet e organeve te Federates Shqiptare te JUDO-s nuk mund te jene objekt ankimimi dhe gjykimi ne Gjykatën Civile. Kunder ketyre vendimeve mund te apelohej ne Keshillin e Arbitrazhit Sportiv prane KOSH dhe me te drejte ankimimi ne Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv CAS Lausanne, vendim i se ciles eshte i formes se prere.

NENI 10

MENYRA E SHPERNDARJES TE FEDERATES

Federata shperndahet me vendim te mbledhjes se Asamblese se pergjithshme te Anetareve sipas statutit bashkelidhur.

Ne rast mosmarrveshjes brenda Federates Shqiptare te JUDO-s, te cilat cojne ne paralizimin e aktivitetit dhe veprimtarise se federates, ministri pergjegjes per sportin ka te drejte te pezulloje veprimtarine e organeve drejtuese te Federates Shqiptare te JUDO-s dhe te emeroje me mandat te perkohshem nje kryetar te Federates Shqiptare te JUDO-s per te drejtuar veprimtarine e kesaj federate dhe per te pergatitur thirrjen e assemblese se jashtezakonshme zgjedhore.

Ne rast shperndarjeje te federates ajo cregjistrohet , pushon veprimtarine e saj dhe vihet ne likuidim nga komisioni i likuidimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve ne fuqi.

Ky akt themelimi hyn ne fuqi dite e regjistrimit te Federates ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor te Tiranes ne kete dite Federata njihet edhe si person juridik.

Shoqata "KLUBI SPORTIV JUDO"ANTON SHKOZA,
perfaqesuar nga kryetari i saj z.Çesk Kimça



Shoqata "TOP GYM SPORT"
perfaqesuar nga kryetari i saj z. Leonidha Kapri

Leonidha Kapri

